



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.47/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Delushe Halimi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga i dënuari Blerim Bajqinovci, nga fshati P., Komuna e P., kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.nr.39/25, datë 05.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 28.02.2025, merr këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të dënuarit Blerim Bajqinovci, nga fshati P., Komuna e P., ndërsa aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.39/25, datë 05.02.2025, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.nr.39/25, datë 05.02.2025, refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit Blerim Bajqinovci, nga fshati P., Komuna e P., kurse, me pjesën e II të dispozitivit të tij, kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 4 (katër) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër aktvendimit të sipër përmendur i dënuari Blerim Bajqinovci, me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të ligjit material, me pretendim se i ka plotësuar kushtet ligjore për lirim me kusht, andaj, ka propozuar që ankesa të miratohet si e themeltë, aktvendimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të aprovohet e bazuar kërkesa për lirim me kusht ose që aktvendimi të prishet dhe çështja të kthehet në rivendosje në panelin për lirim me kusht.

Paneli për Lirim me Kusht, në përgjigje të ankesës, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të goditur, pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje të ankesës, si dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.147/22, të datës 19.05.2022, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.316/23, të datës 08.09.2023, Blerim Bajqinovci është shpall fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 1,500€. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Pml.nr.619/2023, të datës 06.12.2023, ka refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga i dënuari.

Paneli për Lirim me Kusht, ka mbajtur seancën më datë 05.02.2025, ku ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën – Premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimimit me kusht, siç është përcaktuar me nenin 116 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, etj, dhe ka vërtetuar se i dënuari lirim normal e ka më datën 15.01.2026 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rrjedh se të njëjtit i kanë mbetur edhe 11 muaj e 10 ditë qëndrimi në vuajtje të dënimit. Nga raporti i ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, rezulton se i dënuari ka treguar sjellje të mira, ka konsideruar të mesme rrezikshmërinë për recidivizëm, ndërsa të ulët ndaj komunitetit. Në të dhënat për realizimin e planit të dënuarit, është konstatuar se i dënuari është i angazhuar me punë, gjendet në pavijonin nr. 4 në tretman të avancuar me beneficione. Po ashtu, sipas ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese mbajtja e dënimit me burgim ka arritur qëllimin e dënimit dhe se procesi i risocializimit ka rrjedh mirë duke shënuar progres.

Paneli për Lirim me Kusht, i ka vlerësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në lirimin me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht. Rrethanat përfshijnë: përkrahimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, planet e të dënuarit pas lirimimit, pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ShSK, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për shoqërinë/komunitetin, programet rehabilituese të ndjekura nga personi i dënuar, vlerësimin e progresit të arritur te i dënuari në planin individual të rehabilitimit dhe rrethanat e tjera të vlerësuara nga paneli që tregojnë se i njëjti nuk do të kryej veprë penale.

Paneli pas shqyrtimit të dosjes, vlerësimin të kushteve dhe rrethanave të përcaktuara në rregullore, konstatoi se nuk është arritur risocializimi te i dënuari për shkak të mbetjes së dënimit për tu mbajtur dhe se të dënuarit duhet t'i vlerësohen ende sjelljet në mënyrë që të arrihet risocializimi i plotë. Kategorizimi se ekziston rrezikshmëria tregon një indikator tjetër që të dënuar duhet ende kohë për të vlerësuar rrezikshmërinë e mbetur. Po ashtu, ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese nuk ka dhënë konstatim se është arritur risocializimi, andaj marr parasysh fakti se risocializimit është një proces që siguron se i dënuari është i gatshëm që të ri integrohet në shoqëri pa rrezik për t'u kthyer në veprime të paligjshme dhe mungesa e një konstatimi të tillë nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, tregon se procesi i risocializimit nuk ka përfunduar. Si përfundim, Paneli ka ardhur në përfundim se nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal, i paraparë me dispozitën e nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për çka kërkesa e të dënuarit është refuzuar për periudhën kohore prej 4 muajsh dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Duke u nisur nga gjendja e këtyllë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të Panelit për Lirim me Kusht, përkitazi me refuzimin e kërkesës për lirim me kusht të dënuarit Blerim Bajqinovci, si në dispozitivin e aktvendimit të tij, pasi që ky aktvendim nuk është përfshirë me shkelje ligjore të dispozitave procedurale dhe materiale, nga se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin e tij, kurse në arsyetim janë dhënë arsyet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj konsideron se pretendimet ankimore lidhur me shkeljet e pretenduara, nuk mund ta vënë në pyetje aktvendimin e goditur të sipër përmendur të Panelit për Lirim me Kusht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Paneli për Lirim me Kusht, përkitazi me vendosjen e rastit konkret, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e nenit 38 par.1, pikat 1.1 deri 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku veç tjerash, në kuadër të qëllimit të dënimit, parashihet; të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale etj, sikundër që ka zbatuar drejtë edhe dispozitat e nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, që kanë të bëjnë me qëllimin e ekzekutimit të sanksioneve penale, si aspekti i risocializimit, i ri integritetit të dënuarit në shoqëri, përgatitjen e tij për jetë dhe për sjellje të përgjegjshme etj. Në këtë kontekst, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me rastin e vendosjes Paneli për Lirim me Kusht, ka pasur parasysh dhe ka zbatuar drejtë edhe dispozitën e nenit 11 të Rregullores së KGJK-së Nr.12/2023, për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, që ka të bëjë me peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimi i personit të dënuar për krimin, sjellja e mirë gjatë burgimit, gjendja psikiatrike apo psikologjike, gjendja fizike, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për publikun, planet e personit të dënuar pas lirimit etj. Si rrjedhojë, kjo Gjykatë vlerëson se Paneli për Lirim me Kusht, kur ka vendosur për refuzimin e kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, për periudhën 4 mujore, me mundësinë e rishqyrtimit të saj, pas kalimit të këtij afati, ka marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, pasi që ndër të tjera nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese ka rezultuar se në rastin e të dënuarit Blerim Bajqinovci, ende nuk është arritur risocializimi.

Për arsyet e paraqitura si më lart dhe në pajtim me nenin 117 paragraf 11 dhe 12 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.47/2025, datë 28.02.2025

Kryetar i kolegjit,  
Lumni Sallauka